




Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj

# MONITORIMI I MEDIAVE ONLINE GJATË MUAJIT JANAR

Janar, 2024



# PËRMBAJTJA

---

- 1** METODOLOGJIA ..... 3
- 2** TË GJETURAT KRYESORE ..... 4-5
- 3** SHEMBUJT NË GJUHËN SHQIPE ..... 6-9
- 4** SHEMBUJT NË GJUHËN SERBE ..... 10-11

# MONITORIMI I MEDIAVE ONLINE GJATË MUAJIT JANAR

## 1 Koha e monitorimit

1-31 Janar

## 2 Fushë veprimi

Çrregullimi i informacionit në internet dhe mediat sociale: Uebfaqe, portalet online të lajmeve, Facebook, Youtube, TikTok dhe Instagram.

## 3 Mostra

Në gjuhën shqipe dhe serbe.

## 4 Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti është monitorimi i çrregullimeve në mediat online në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, rreth zhvillimeve/ngjarjeve që kanë ndodhur gjatë muajit janar në Kosovë.

*Ky raport është përparitur nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në kuadër të projektit “Mbulueshmëria dhe kuptueshmëria e çrregullimit të informacionit në Kosovë”, që mbështetet nga NDI dhe USAID në Kosovë. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Institutit Demokraci për Zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NDI Kosovo.*

## 2. METODOLOGJIA

Qëllimi i Institutit Demokraci për zhvillim (D4D), është identifikimi dhe luftimi i lajmeve me çrregullim të informacionit, trend ky në rritje i përhapjes së lajmeve me çrregullim të informacionit. Institutit D4D, ka bërë monitorimin e mediave online dhe atyre sociale për të identifikuar lajmet/artikujt të cilat përmbajnë çrregullime të informacionit, përmes një platforme monitoruese, duke klasifikuar artikujt në bazë të kategorive: zhvillimet në veri; dialogu Kosovë-Serbi; gjuha e urrejtjes; dhuna online ndaj grave; ndasitë politike dhe ndikimi ndërkombëtar. Mediat online të cilat janë monitoruar përmes platformes kanë qenë mbi 100 media online vendore, të rajonit dhe ndërkombëtare, të selektuara në një platformë monitoruese. Monitorimi dhe analizimi i artikujve me çrregullim të informacionit është bërë paralelisht në dy mostra: në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Përzgjedhja e shembujve nga të dyja mostrat është bërë duke u bazuar në përmbajtjen e artikullit i cili ka shpërndarë: dezinformata, manipulim të fakteve, përmbajtje të paverifikuara, lajm të pavërtetë, teori konspirative, clickbait, gjuhë të urrejtjes, gjuhë ofenduese, gjuhë kërcënuese, nxitëse, artikuj me tituj tendencioz, dhe raportim të njëanshëm. Kategoritë të cilat kanë mbizotëruar gjatë muajit nëntor në mostrën e gjuhës shqipe kanë qenë: zhvillimet në veri, ndasitë dhe polarizimi politik kurse në mostrën në gjuhën serbe mbetet zhvillimet në veri. Prej secilës mostër janë verifikuar 1000 artikuj me lexueshmërinë më të madhe. Në mostrën në gjuhën shqipe nga 1000 artikuj, rreth 460 kanë rezultuar me çrregullim të informacionit, kurse në mostrën në gjuhën serbe nga 1000 artikuj të analizuar, rreth 600 kanë rezultuar me çrregullim të informacionit.

### 3. TË GJETURAT KRYESORE

- **Rishfaqja e lajmeve të vjetra si Clickbait:** Për të rritur klikimet, lajmet e vjetra ripaketohehen dhe paraqiten si ngjarje aktuale, duke u mbështetur në sensacionalizimin e lajmit si një e vërtetë aktuale. Rikthimi i artikujve dhe lajmeve të kaluara si një ngjarje aktuale duke shtrembëruar të vërtetën, si në rastin e intervistës së Kryeministrit Kurti i cili kishte dhënë një intervistë për një medium gjerman, e që pjesët e redaktuara nga intervista janë të cilësuar si skandal, kur vet gazetari kishte treguar se nuk ka pasur asgjë për tu fshehur thjesht artikulli kishte përfshirë vetëm gjërat që ju intereson publikut gjerman. Rikthimi i artikujve të vjetër nuk përbëjnë ndonjë informacion të ri, mirëpo përdorimi i artikujve në fjalë për të nxjerrë ndonjë skandal në sy të lexuesve cilësohet si clickbait( karrem për klikueshmëri).
- **Mungesa e burimeve dhe informacioneve të besueshme:** Artikujt nuk japin burime të besueshme ose informacione thelbësore që mbështesin titujt e tyre të bujshëm, duke çuar në dezinformata. Fenomeni i titujve të bujshëm që nuk përputhen me përmbajtjen e artikujve ose nuk japin informacion faktik është një tendencë shqetësuese në mediat online. Kjo praktikë e mediave online përdoret përmes krijimit të titujve për të tërhequr vëmendjen e lexuesit pavarësisht nga saktësia ose rëndësia e përmbajtjes. Problemi me titujt e bujshëm është mos përputhshmëria me përmbajtjen e artikujve. Zakonisht përfshihen deklaratat apo pohime të guximshme pa ofruar argumenta apo fakte të mjaftueshme dhe të besueshme. Artikujt në fjalë kanë ndikim serioz në situata të ndjeshme dhe serioze, si në rastin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi. Dezinformimi përmes titujve të bujshëm sjellin ndasi dhe polarizim brenda shoqërisë. Për më tepër vëmendja e informacionit nga çështje të rëndësishme dhe komplekse bartet te artikujt me tituj të bujshëm që përbëjnë dezinformim.
- **Elementet spekulative:** titujt që përdorin gjuhë me elemente spekulative në lidhje me konflikte të mundshme në Kosovë që nxisin gjuhë agresive ndëretnike duke rritur rrezikun e përshkallëzimit të konfliktit, dhe duke nënvlerësuar përpjekjet diplomatike të Kosovës dhe Serbisë për të promovuar paqen dhe stabilitetin. Spekulumet ndodhin kur bëhen pohime ose nxjerrin përfundime bazuar në informacione jo të plota ose burime të paverifikuara. Në një shkallë, spekulimi është i natyrshëm në parashikimin ose analizimin e ngjarjeve të ardhshme, mirëpo spekulimet e tepërta ose të pabaza mund të paraqesin sfida për besueshmërinë e medias dhe saktësinë e informacionit të paraqitur në publik. Problemi kryesor në lidhje me spekulimin është potenciali për keqinformim të lexuesve

### 3.

- **Përdorimi selektiv i fakteve dhe citimeve:** Narrativat e paverifikuara krijohen duke përdorur faktet në mënyrë selektive dhe citate, të cilat shpesh nxirren jashtë kontekstit për t'iu përshtatur storieve të pregaditura, duke shtrembëruar kështu perceptimin publik. Në mostrën në gjuhën serbe janë vërejtur raste ku janë përdorur statistika të mbledhura nga Iniciativa Europiane për Stabilitet, një artikull të shkruar mbi besueshmërinë ndaj fakteve dhe statistikave që japin figurat politike serbe, të cilat përmenden në raport. Nga i gjithë raporti i IES-së, mediat serbe në mënyrë selektive citojnë vetëm pjesët që përputhen me storiet e pregaditura jashtë kontekstit të raportit të publikuar nga IES.
- **Artikuj të paverifikuar:** në lidhje me spastrimin etnik të komunitetit serb në Kosovë: Përhapja e vazhdueshme e narrativave të paverifikuara, siç është spastrimi etnik i serbëve në Kosovë dhe kërcënimet nga qeveria e Kosovës ndaj komunitetit serb nxit frikën dhe përçarjen dhe duke u shërbyer qëllimeve politike dhe jo të vërtetës.

## 4. SHEMBUJ NË GJUHËN SHQIPE

Portali Epilogu ka postuar një artikull me titull: Mediumi gjerman FAZ: Politikat e Kurtit në përputhje me planet serbe për destabilizim të rajonit. Artikulli nga Epilogu përmend se sot (data 3 janar 2024) është publikuar një artikull nga mediumi gjerman Frankfurt Allgemeine Zeitung (FAZ), megjithatë D4D ka gjetur se lajmi në gjuhën gjermane ishte publikuar në qershor të vitit 2023.

Gjuha e përdorur në titullin e postuar “Politikat e Kurtit në përputhje me planet serbe për destabilizim në rajon” ka elemente të keqinterpretimit të lajmit, pasi që titulli në fjalë mund të interpretohet sikur “politikat e Kurtit janë bërë qëllimshëm në përputhje me planet serbe”. Mirëpo, gazetari gjerman, MICHAEL MARTENS, shkruan se vendimet e Kurtit po ja bëjnë më të lehtë Vuçiqit destabilizimin në rajon.



### Mediumi gjerman FAZ: Politikat e Kurtit në përputhje me planet serbe për destabilizim të rajonit

January 3, 2024 1 minute read



Frankfurter Allgemeine Zeitung (FAZ) ka botuar sot një artikull për tensionet e fundit në veri të Kosovës. Dhe ky artikull, ani pse është përgatitur nga Michael Martens që e kishte intervistuar Kurtin para disa

Për më tepër Epilogu përmend intervistën që gazetari Martens kishte realizuar më herët me Kryeministrin Kurti duke përfshirë edhe faktin se gazetari i është dashur të largojë disa pjesë “të rëndësishme” nga intervista që lë hapsirë për krijim të një skandali .

“Ai i kishte hequr Kurtit fjalët më të rëndësishme nga një intervistë në muajin nëntor, ku kryeministri e pranonte që ambasadori amerikan kishte ditur më shumë mbi situatën në veri të vendit, çka e kishte shtyrë që të tërhiqej nga çështja e targave ilegale.”- Epilogu

Gazetari gjerman në vitin 2022, kur ishte realizuar intervista, ishte sqaruar se të gjitha pjesët e hequr ishin të aprovuara nga ekipi i kryeministrit Kurti, por nuk e ka konsideruar si të rëndësishme për ta mbajtur në draftin final. Përmes X(ish Twitter) ai kishte sqaruar se pjesa e hequr nuk kishte shumë rëndësi për lexuesit gjerman dhe prandaj intervista për të qenë më e shkurtër janë hequr disa pjesë.

“Disa duket se e konsiderojnë skandal (ose duan ta shndërrojnë në të tillë) që ambasadori amerikan në momente të caktuara mund të dijë më shumë për situatën e sigurisë në rajone të caktuara (në këtë rast në veri të Kosovës) sesa një kryeministër. Por a është ky një skandal? – M. Martens.



E thënë vetë nga gazetari Martens, ka tendenca që lajme dhe intervista të caktuara të përdoren në kontekste të tjera duke e marrë të vërtetën dhe duke e interpretuar ndryshe me qëllim që të krijohen skandalet. Lajmet e bëra bujë kohë më parë rikthehen si lajme aktuale për klikueshmëri. Lajm i shpërndarë nga mbi 10 medime online kanë grumbulluar rreth 36.000 klikime në faqet e tyre të internetit.



Artikulli i postuar nga Ora info me titull: **Mediat serbe: Pas ndalimit të dinarit, ushtria serbe duhet të hyjë në Kosovë**

Lajmi i publikuar nuk sqaron në detaje situatën për të cilën flitet në titull. Lajmi në përmbajtje përfshinë vendimin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) dhe procedurat e mëtejshme, gjithashtu se Vucic kishte bërë thirrje ndërkombëtarve se heqja e dinarit e bën jetën e serbëve më të vështirë.

Artikulli nuk ka arritur të jap informata dhe burime të besueshme në lidhje me titullin e vendosur, prandaj cilësohet si dezinformatë dhe kjo formë e shkrimit përdoret si karrem për të mbledhur klikime (clickbait). Linku nuk punon pasi që mund të jetë fshirë, mirëpo në Facebook postimi ende qëndron dhe vetëm postimi në Facebook ka grumbulluar 27 pëlqime, 2 komente dhe 11 shpërndarje. dhe rreth 180 klikime ne faqen online




Artikujt e publikuar nga Bota Sot me titujt:

**Taktika serbo-ruse për destabilizimin e Ballkanit – Zbardhen “skenarët”: Kosova dhe dy shtete të tjera në rrezik, Shqipëria.**

**“Lufta është e pashmangshme”, eksperti austriak jep parashikimin e keq: Kosova dhe ky shtet të bëhen gati - ja planet e ekstremistëve serbë!**

Narrativat të cilat janë publikuar gjatë muajve të fundit në lidhje me konfliktet e mundshme në Ballkan me theks të veçantë midis Kosovës dhe Serbisë po vazhdojnë. Lajmi në titullin e parë ka informatë shqetësuese duke pretenduar se zbulohen taktika të rëndësishme serbo-ruse që synojnë të destabilizojnë Ballkanin. Në hyrje të përmbajtjes së lajmit përmendet pikëpamja e një eksperti austriak në lidhje me sigurinë në Ballkan, ndërsa pjesa dërrmuese e lajmit ka narrative se si mund të destabilizohet Ballkani dhe qfarë veprimesh mund të ndërmeren nga Serbia në vitin 2024.

Artikulli ka tone të ekzagjerimit të situatës sidomos në titull ku fjalia është lënë e pa përfunduar, për të shtyrë lexuesit të lexojnë artikullin. “Zbardhen skenarët” lë të kuptohet se ka organizim për një konflikt në vitin 2024 dhe cilat shtete rrezikohen, por nuk përmenden burimi apo edhe ndonjë fakt që vërteton pretendimet apo taktikat për destabilizim. Njëjtë dhe në artikullin e dytë u pretendua se shkurti i vitit 2024 do të jetë me konflikte dhe sulme.



The screenshot shows the website 'BOTA SOT' with a navigation menu including 'BALLINA', 'LAJME', 'BOTA', 'KOSOVA', 'SHQIPËRIA', 'MAQEDONIA', 'SPORTI', 'SHOWBIZ', 'DIASPORA', and 'RUBRIKAT'. The main article is titled 'Taktika serbo-ruse për destabilizimin e Ballkanit – Zbardhen “skenarët”: Kosova dhe dy shtete të tjera në rrezik, Shqipëria..'. The author is 'NGA: M.LAKNA' and the date is '1 ME 2 JANAR 2024 NE ORA: 17:59'. There is a 'FOTOGALERI' section with an image of military tanks. On the right, there is a 'MË TË LEXUARAT' section with several article teasers.

**POLITIKA**

**“Lufta është e pashmangshme”, eksperti austriak jep parashikimin e keq: Kosova dhe ky shtet të bëhen gati - ja planet e ekstremistëve serbë!**

NGA A.M. ME 27 JANAR 2024 NË ORA 18:01



Titujt e sensacionalizuar dhe të pabazuar si "taktikat serbo-ruse për destabilizimin e Ballkanit" dhe "Lufta është e pashmangshme" përbëjnë një rrezik të konsiderueshëm për përshkallëzimin e tensioneve dhe nxitjen e destabilitetit në rajon. Këta tituj, të cilët përdorin gjuhë të ekzagjeruar dhe parashikime të tilla, kanë potencialin për të nxitur panik dhe pasiguri, duke nxitur gjithashtu urrejtje nder-etnike. Publikime të tilla dezinformojnë lexuesit, ndërkohë që kontribuojnë në një klimë pasigurie dhe shqetësimi duke nënkuptuar ekzistencën e planeve të përcaktuara dhe konflikteve të afërta pa ofruar burime me reputacion ose të dhëna të verifikueshme.

.Për më tepër, përdorimi i qëllimshëm i gjuhës provokuese dhe supozimeve spekulative në këta tituj rrit rrezikun e përshkallëzimit të konfliktit dhe minon përpjekjet diplomatike Kosovë-Serbi për të promovuar paqen dhe stabilitetin. Mungesa e burimeve të verifikuara në artikuj i bën pretendimet të diskutueshme, pavarësisht depertimitë tyre ne opinioint publik. Gjatë janarit Bota sot ka arritur të ketë rreth 330.000 klikime në faqen online.

## 6. SHEMBUJ NË GJUHËN SERBE

Mediumi Kosovo Online pothuajse çdo ditë publikon artikuj me tituj që theksojnë se regjimi nga Prishtina ushtron terror te komuniteti serb. Në disa artikuj ka edhe statistika se po bëhet spastrim etnik dhe se për shkak të terrorit serbët në veri po largohen nga Kosova. Këto statistika theksohen të jenë të marra prej një publikimi nga Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI) me titull: 'Statistikat, gënjeshtrat dhe konfuzioni në Kosovë', e cila heton vërtetësinë e të dhënave të ofruara nga politikanët serbë, përderisa publikimi i ESI ngre çështje legjitime për cilësinë e këtyre numrave.




Përmbajtja e paverifikuar e Kosovo Online përfshin përdorimin selektiv të fakteve dhe citimeve, shpesh të nxjerra jashtë kontekstit për t'iu përshtatur një narrative të planifikuar. Për shembull, ndërsa revista ESI dyshon në vërtetësinë e statistikave të krimit të paraqitura nga zyrtarët politikë serbë, Kosova Online ofron të njëjtat shifra si dëshmi të vërteta të spastrimit etnik dhe dhunës kundër serbëve në Kosovë. Kosova Online informon audiencën e saj duke lënë jashtë nuancat kritike, që kontribuojnë në një përshtypje të shtrembëruar të rrethanave të rajonit dhe duke krijuar armiqësi ndërmjet popullsisë etnike.

Kosova Online është vërejtur të publikojë artikuj me një narrativë të tillë, veçanërisht për tensionet etnike dhe shkallën e krimit në rajon. Këta artikuj theksojnë shpesh statistikat që pretendojnë të tregojnë spastrim etnik dhe eksodin serb nga Kosova si rezultat i aktiviteteve të dyshuara terroriste.

Duke përdorur në mënyrë selektive statistikat dhe duke ekzagjeruar rëndësinë e tyre, Kosova Online përhap keqkuptime dhe inkurajon mosmarrëveshjet në komunitet. Për më tepër, përdorimi i burimeve të besueshme ndërkombëtare për t'i dhënë peshë narrativave të rreme e përkeqëson problemin e dezinformimit. Për të negociuar natyrën komplekse të shpërndarjes moderne të informacionit, konsumatorët e medias duhet të përdorin aftësinë dalluese kritike dhe të kërkojnë perspektiva të shumta.

Duke përdorur në mënyrë selektive statistikat dhe duke ekzagjeruar rëndësinë e tyre, Kosova Online përhap keqkuptime dhe inkurajon mosmarrëveshjet në komunitet. Për më tepër, përdorimi i burimeve të besueshme ndërkombëtare për t'i dhënë peshë narrativave të rreme e përkeqëson problemin e dezinformimit. Për të negociuar natyrën komplekse të shpërndarjes moderne të informacionit, konsumatorët e medias duhet të përdorin aftësinë dalluese kritike dhe të kërkojnë perspektiva të shumta.



Disa nga titujt e tjerë të publikuar gjatë muajit janar nga Kosovo Online:

**Petkovic: Heqja e transaksioneve të pagesave që synojnë eksodin e serbëve; të gjithë në Prishtinë po përdorin euron në mënyrë të paligjshme**

**Ministria e Kulturës së Serbisë: Prishtina vazhdon dhunën ndaj trashëgimisë kulturore, duke synuar të fshijë gjurmët e ekzistencës serbe në Kosovë dhe Metohi**

**Jevtic: Sulmet ndaj serbëve të kthyer janë rezultat i politikës së regjimit në Prishtinë**

Gjatë muajit janar Kosovo Online ka arritur të grumbullojë rreth 81.000 klikime në faqen online, ku 81% e tyre janë në Serbi, pjesa tjetër në Ballkan dhe 6% në diasporë.

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendimmarrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndërsektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik. Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: **[www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)**

Mbështetur nga:

